



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Komuna e Mitrovicës së Jugut**  
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

## **KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT**

**Komiteti për Politikë dhe Financa**

**Nr. 02-060/01-0030237-1/25 dt. 30.05.2025**

**Mitrovicë**

### **PROCESVERBAL**

**Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa**

**Mbledhja e 41**

**Koha:** 25.04.2025 ora 10:00

**Vendi:** Salla e Mediave

**Të pranishëm:** Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Vesel Neziri, Hysen Muzliukaj, Erseka Barani, Muhamed Hoti dhe Xhylyeta Imeri

Drejtorët e Drejtorive

**Mungoi:** Shkurta Shosholli Musa

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11 paragrafët: 1, 2 edhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen e 41-të të Komitetit për Politikë dhe Financa, me këtë:

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Qarkorja Buxhetore 2026/01

**Rendi i ditës u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime).**

## Pika 1

**Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimitisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime).**

## Pika 2

Kryesuesja para se të hapë diskutimin lidhur me Qarkoren Buxhetore 2026/01 për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kalo Drejtoreshës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa znj. Igballe Islami.

Igballe Islami: Realisht sot kemi me diskutu vetëm qarkoren, si të tillë e kemi pranuar sipas ligjeve në fuqi dhe Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike. Çka është për me u potencuar që Komunës së Mitrovicës këtë vit i është nda buxheti bazuar në regjistrimin e fundit nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Kështu që buxheti është nda për kokë banori, e që tash jemi vlerësu me 64 mijë banorë që pa dyshim ka ndiku në vlerën totale të përgjithshme të buxhetit të Komunës së Mitrovicës. Buxheti i bazuar në komisionin e granteve është ndarë nëpër grande, domethënë grandit i përgjithshëm, grandit specifik për arsim, grandit specifik për shëndetësi, financimin për teatër, financimin për shërbimet rezidenciale dhe i kemi edhe të hyrat vetanake. Në total, buxheti sipas Komisionit për ndarjen e granteve në nivel të Republikës së Kosovës, Komuna e Mitrovicës ka përfitu në total 32,418,756 euro, ose krahasuar me buxhetin e këtij viti është 6% vlerë më e madhe. Nëse shkojmë te grantet, ne i kemi analizu se cili grant ka përfitu, më së shumti është granti i përgjithshëm edhe çfarë është për mu befasu ose neve si Komunë e Mitrovicës, po vlerësoj që na ka dëmtu është që te granti specifik për shëndetësi nuk e kemi asnjë vlerë, domethënë rritje, domethënë granti është i njëjtë si në vitin e kaluar si në këtë vit, ndërsa 6% është rritje granti specifik për arsim. Ne tash veç e kemi përfunduar edhe Kornizën Afatmesme Buxhetore, jemi në përfundim e sipër do ta mbajmë bashkë me Kryesuesen e Kuvendit konsultimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore. Mirëpo vlerësimet tona të para janë që kjo vlerë e rritjes së buxhetit do të destinohet në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje ku jemi duke e parë që për shkak të kontratës kolektive edhe këtë vit më shumë se vitin e kaluar jemi dobësuar në kategorinë e pagave, kështu që po vlerësojmë që kjo rritje ka me shku pikërisht në kategorinë paga dhe mëditje ndoshta shumë pak nëpër kategori tjera. Të hyrat vetanake janë 3.7 milionë, 3.6 milionë kanë qenë, si të tillë e kemi pranuar Qarkoren, nuk do të thotë që po pajtohem as ne po kështu ka vendosë Komisioni i Granteve edhe si të tillë na veç kena me procesin për Kornizën Afatmesme Buxhetore.

Hysen Muzliukaj: A ka mundësi Drejtoreshë me na e dërgu një analizë, një impakt të kësaj që u fol deri tash, me pasë të qartë se ku këna me u dëmtu më shumë edhe prej granteve edhe impakti i borxheve të krijuara të cilat janë paguar, e ne kemi menduar se vjen buxheti ose qarkorja e njëjtë, pra cili ka me qenë impakti i këtij ndryshimi, besoj që e kemi analizu, këto të na dërgohen me e-mail ose me material për Kuvend.

Igballe Islami: Po ua dërgojmë me e-mail.

Fadil Veseli: Qarkorja buxhetore është hapi i parë drejt miratimit të buxhetit se kah po orientohen investimet dhe buxheti i vitit të ardhëm. Formula e përgjithshme është sipas numrit të banorëve, prandaj me rënien e numrit të banorëve është zvogëluar edhe shuma e paraparë për buxhet. U cek nga Drejtoresha se ka rritje minimale, 6%, po që në realitet nuk është rritje nëse merret parasysh baza e inflacionit atëherë nuk është rritje, por është zbritje, për shkak se inflacioni ka ecur edhe është duke ecur kurse shumë prej 6% e shkrinë inflacioni, sidomos tash me krizën që po parashihet me shtrenjtimin e energjisë elektrike. Kjo qarkore është me rëndësi se është bazë

e buxhetit, kjo shumë do të shpërndahet sipas kategorive, besoj që pjesa më e madhe të shpërndahet në Investime Kapitale.


Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Qarkoren Buxhetore 2026/01.

**Komiteti për Politikë dhe Financa pasi u informua me Qarkoren Buxhetore 2026/01 vendosi që e njëjta si informatë t'i procedohet Kuvendit të Komunës.**


**Mbledhja përfundoi punimet në ora 10:30 min.**

Mitrovicë

Procesmbajtës:

  
Merita PRETENI

Kryesuesja e Kuvendit

  
Vesa BROJA

